

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Lumni Sallauka - kryetar i kolegjit, Burim Shala dhe Valon Totaj anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit SH.K. nga Gjilani, rr.“...., kundër të paditurës Komuna e Gjilanit-Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën e përfaqeson i autorizuari B.D. nga Gjilani, me objekt të padisë kompensimin e pagave jubilarë, duke vendosur sipas ankesës së të paditësit e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan C.nr.738/2012, të datës 18.12.2013, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 25.05.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pa themeltë ankesa e paditësit SH.K. nga Gjilani, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan C.nr.738/2012, i datës 18.12.2013, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.738/2012, të datës 18.12.2013, në pjesën e parë të dispozitivit e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit SH.K., nga Gjilani, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Komuna e Gjilanit-Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan, që paditësit t’ia paguajë shumën e të hollave prej 728.40 euro në emër të dy pagave përcjellëse, shumën prej 728.40 euro në emër të shpërblimit jubilar, si dhe shumën prej 120 euro në emër të regresit, me kamatë që e paguan banka për depozitim mbi një vit, duke filuar nga data 22.10.2012, deri në ditën e pagesës, në pjesën e dytë të dispozitivit ka vendosur që të detyrohet paditësi që gjykatës së shkallës së parë t’ia paguajë taksën gjyqësore për vendim në vlerë prej 20 euro, ndërsa në pjesën e tretë të dispozitivit ka vendosur që secila palë ti bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi paditësit në afatin ligjor ka paraqitur ankesë duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjëndjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të abrogohet, ndërsa lënda t’i kthehet në rigjykim Gjykatës Themelore në Gjilan ose i njëjti të ndryshohet në atë mënyrë që kërkesëpadia e paditësit të aprovohet si e bazuar.

E paditura nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e paditësit është **e pathemeltë**.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësi ka ushtruar padi ndaj të paditurës, me kërkesë që të obligohet e paditura Komuna e Gjilanit-Drejtoria Komunale e Arsimit që paditësit t’ia paguajë shumën e të hollave prej 728.40 euro në emër të dy pagave përcjellëse, shumën prej 728.40 euro në emër të shpërblimit jubilar, si dhe shumën prej 120 euro në emër të regresit,

shuma neto prej 1.576.80 €. Gjithashtu e paditura detyrohet ti paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotëfuqishmerisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë. Poashtu, e paditura ka parashtruar përgjigje në padi me datë 04.11.2013, ku e ka kontestuar kërkesëpadinë e paditësit me propozim që padinë dhe kërkesëpadinë të refuzojë në tërësi si të pabazuar.

Gjykata e shkallës së parë ka mbajtur shqyrtimin kryesor dhe pas administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar me numër C.nr.738/12, datë 18.12.2012, me të cilin në tërësi e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar gjykata ka theksuar se nuk ka qenë kontestuese se paditësi kishte qenë në marrëdhënie të punës tek e paditura, në vendin e punës në cilësinë e arsimtarit të lëndës së Historisë, në Shkollën Filllore "Thimi Mitko" në Gjilan, nuk është kontestues që paditësi është pensionuar me vendimin e të paditurës, me datë 10.11.2011, i cili më pas i është drejtuar të paditurës me kërkesë për kompensimin e pagave përcjellëse dhe atyre jubilarë. Në fund gjykata e shkallës së parë e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit për shkak se në kohën e pensionimit të tij nuk ka qenë në fuqi kontrata e përgjithshme kolektive, përmes së cilës edhe ka qenë e garantuar e drejta për realizimin e pagave jubilarë dhe atyre për përcjellje në pension.

Gjykata e Apelit e aprovon në tërësi vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, neni 183 al.1 të LPK-së, dhe rrjedhimisht nuk ka aplikim të gabuar të drejtës materiale për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditësit se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaftë i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjykata e Apelit e aprovon në tërësi arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë sa i përket vendosjes lidhur me refuzimin e kërkesëpadisë së paditësit që në emër të shpërblimit jubilar dhe pagave përcjellëse për pension t'ia kompensoj shumën e kërkuar me kërkesëpadi, për faktin se kontrata kolektive e cila ka hyrë në fuqi me datë 01.01.2005, ka qenë e aplikuar për tri vite, që do të thotë deri më 31.12.2007, ndërsa paditësi ka dalë në pension me datë 10.11.2011, që do të thotë pas kalimit të afatit tre vjeçar për të cilin ka qenë në fuqi Kontrata e Përgjithshme Kolektive. Si rrjedhojë, në kohën e pensionimit të paditësit ka munguar baza ligjore për kompensimin e të ardhurave në emër të pagave jubilarë dhe atyre për përcjellje në pension, pasi kontrata e përgjithshme kolektive është përtërirë dhe ka filluar të zbatohet prej datës 01.01.2015

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 195.1 pika d), lidhur me nenin 200, të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.188/14, datë 25.05.2015

Kryetari i kolegjit,
Lumni Sallauka